

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8577, DATË 10.2.2000, ‘PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Një ndër rezultatet e reformës në drejtësi ishte edhe miratimi i ndryshimeve ligjore në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, me ligjin nr.99/2016. Këto ndryshime ligjore pasqyruan ndryshimet kushtetuese në drejtimit të mënyrave të reja të përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues, kompetencave të reja të kësaj Gjykate në trajtimin në veçanti të ankimit kushtetues individual, statusit të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës, si dhe rregullat e reja për shqyrtimin e çështjeve. Ligji nr.8577, datë 10.2.2000, ndryshoi më tej në vitin 2021 me ligjin nr.45/2021.

Gjykata Kushtetuese ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë propozimin për ndryshime në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese me qëllim rritjen e pagës së gjyqtarëve pranë kësaj gjykate, duke e vendosur atë në majën e piramidës së pagave të sistemit të drejtësisë duke qenë se kontrollon kushtetutshmërinë e vendimeve që japin gjykatat e posaçme për krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe kështu mbart çdo vështirësi dhe kompleksitet që haset në punën e tyre, ka përgjegjësinë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve normative, zgjidhjes së konflikteve të kompetencave midis organeve kushtetuese dhe kontrollin e papajtueshmërive dhe kushteve të zgjedhshmërisë të funksionarëve të organeve kushtetuese që nënkupton se gjyqtarët e kësaj gjykate përfaqësojnë nivelin më të lartë të ekspertizës dhe përgjegjësisë, si dhe për shkak se sipas ligjeve që rregullojnë protokollin e shtetit, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese është personaliteti i katërt në hierarkinë protokollare pas Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit.

Kjo kërkesë paraqet disa propozime për shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000, të cilat kanë për qëllim adresimin e nevojave të evidentuara në drejtimit të rregullimit të statusit të gjyqtarit kushtetues.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Nisma e propozuar vjen në përputhje edhe me qëllimet strategjike të Gjykatës Kushtetuese, të parashikuara në planin e veprimit 2021-2023 për të rritur efektivitetin dhe efektshmërinë e veprimtarisë së saj, si dhe me përcaktimet e nenit 124 të Kushtetutës. Projektligji nuk është përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kjo nismë vjen si rezultat i kërkesës së paraqitur nga Gjykata Kushtetuese, në kuadër të nevojës për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së saj, si institucion i pavarur dhe si një gjykatë *sui generis*, e cila administron drejtësinë kushtetuese.

Ligji nr.8577, 10.2.2000, në nenin 17, pika 1, parashikon se: “1. Paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”.

Kudo në botë, sistemi i pagave të funksionarëve publikë i përngjan një strukture piramidale në majë të së cilës qëndrojnë pagat e funksionarëve më të lartë. Të gjitha pagat e tjera përcaktohen bazuar në raporte e koeficiente të gjykuara të përshtatshme nga ligjvënësi, mbi pagën që qëndron në majë të piramidës. Reforma në drejtësi e vitit 2016 e zhbëri sistemin piramidal që ekzistonte deri në atë pikë nisur nga nevoja akute e rindërtimit të sistemit të drejtësisë. Sidoqoftë, lëvizjet e fundit të ndërmarra nga qeveria dhe Kuvendi në fushën e pagave në sektorin publik synojnë rikthimin e “normalitetit” në strukturën e pagave, duke rikthyer, në një masë të madhe, parimin piramidal në ndërtimin e sistemit të pagave. Në këto kushte, bazuar në parimin/konceptin e sipërpërmendur, jemi të mendimit se shtrohet për zgjidhje edhe rishikimi i pagave të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për arsyet e mëposhtme:

- Së pari, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion përfundimtar kontrolli për kushtetutshmërinë e vendimeve që japin të gjitha gjykatat e zakonshme dhe të posaçme, përfshi gjykatat e posaçme për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Në këtë këndvështrim, çdo vështirësi dhe kompleksitet që haset në punën e strukturave të posaçme të ngritura brenda sistemit të drejtësisë, të cilat përbëjnë shkakun në kuptim të politikës legjislative, që përcaktojnë nivelin e pagave të këtyre funksionarëve të drejtësisë,

eventualisht mbarthen në Gjykatën Kushtetuese teksa kjo e fundit shqyrton pretendimet për shkelje kushtetuese në vendimet e tyre. Vlen të theksohet se vetëm vendimet e organeve të sistemit të *vetting*-ut nuk i nënshtrohen juridiksionit kontrollues të Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) funksionon si dhomë e dytë e vetë Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, theksojmë se edhe ky përjashtim nga juridiksioni i përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese përcaktohet nga natyra e përkohshme dhe e jashtëzakonshme e sistemit të *vetting*-ut, i cili do të pushojë së funksionuari në vitin 2026. Në atë kohë, çështjet që gjykon sot KPA-ja (si dhomë e dytë e Gjykatës Kushtetuese), me gjithë vështirësinë dhe kompleksitetin që justifikojnë nivelin aktual të pagave të KPA-së, do të përthithen nga Gjykata Kushtetuese (Dhoma e Parë);

- Së dyti, Kushtetuta e ka veshur Gjykatën Kushtetuese me përgjegjësi ekskluzive për sa i takon kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve normative, zgjidhjes së konflikteve të kompetencave midis organeve të tjera kushtetuese dhe kontrollit të papajtueshmërive dhe kushteve të zgjedhshmërisë të funksionarëve të organeve kushtetuese. Vendimet e Gjykatës mbi këto çështje kanë fuqi të përgjithshme rregulluese dhe qëndrojnë në një nivel më të lartë se ligjet në sistemin e hierarkisë së normave. Këto përgjegjësi të larta nënkuptojnë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese përfaqësojnë nivelin më të lartë të ekspertizës, përgjegjësisë dhe rëndësisë protokollare në sistemin shtetëror. Vendimet e Gjykatës afektojnë jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit njëloj si ligjet dhe në rast përplasjeje me to (ligjet) mbizotërojnë;
- Së treti, nisur edhe nga një këndvështrim ngushtësisht protokollar, kujtojmë se sipas ligjeve që rregullojnë protokollin e shtetit, kryetari i Gjykatës Kushtetuese është personaliteti i katërt në hierarkinë protokollare pas Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit.

Nga ana tjetër, vendosja e Gjykatës Kushtetuese në majën e piramidës së pagave është një standard dhe model që gjendet në të gjitha vendet e zhvilluara.

Për këtë arsye, në kushtet kur sistemi i pagave në sektorin publik po i rikthehet parimit të organizimit piramidial, propozohet që në nenin 17 të bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.96 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Përveç pagës mujore, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese përfiton një shtesë për shkak të natyrës së veçantë të punës, në masën 58% për qind të pagës.”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë:

“2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, për pozicionin drejtues përfiton edhe 20 për qind shtesë page mbi pagën mujore të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe shtesës për shkak të natyrës së veçantë të punës.”.

Shtesa dhe ndryshimet e sipërpërmendura synojnë që nga njëra anë të rrisin pagën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe nga ana tjetër të mos cenojnë të drejtat e fituara të tyre, duke garantuar indeksimin e pagës, si dhe shtesën që përfiton kryetari i Gjykatës Kushtetuese për shkak të pozicionit drejtues.

Në zbatim të nenit 138 të Kushtetutës garantohet indeksimi i pagës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të njëjtë me parashikimet për indeksimin e pagës së magjistratëve sipas ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërkohë, rritja e pagës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese sjell efekte edhe në pagën e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Kjo pasi fjalia e fundit e pikës 3 të nenit C të aneksit të Kushtetutës parashikon se gjyqtarët e Kolegjit të Apelit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa pika 3, e nenit 29, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, ligji për *vetting*-un), parashikon se gjyqtari i Kolegjit të Apelit merr pagë dhe përfitime të tjera financiare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, përmes këtij projektligji është rregulluar edhe çështja e shtesave për natyrë të veçantë pune që përfitojnë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Konkretisht, sipas parashikimeve të pikës 1/1 që i shtohet nenit 17, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të përfitojnë shtesë për shkak të natyrës së veçantë të punës në masën 58% për qind të pagës, ndërsa gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në përputhje dhe zbatim të nenit 29, pika 4, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, do të përfitojnë pagesë mujore shtesë për shkak të vështirësisë, në masën 43% për qind mbi pagën mujore.

Këto dy shtesa kanë natyra të ndryshme dhe lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë dhe kompetencat e secilit prej institucioneve. Kështu, për shkak të

veprimtarisë, kompetencave dhe rolit të veçantë që luan Gjykata Kushtetuese, gjyqtarët e saj do të përfitojnë një shtesë për shkak të natyrës së veçantë të punës. Ndërsa, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit do të përfitojnë vetëm pagesën mujore shtesë për shkak të vështirësisë, në zbatim dhe në përputhje me parashikimet e ligjit për *vetting*-un.

Sa më sipër, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit do të përfitojnë vetëm pagën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 17, të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe jo shtesën për shkak të natyrës së veçantë të punës të cilën e përfitojnë vetëm gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, si pasojë e kompetencave dhe veprimtarisë që kryen ky organ.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 138 të Kushtetutës, si dhe me pikën 3, të nenit C të aneksit të Kushtetutës, për shkak të ndryshimit të formulës së pagës gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit i garantohet shtesa për vjetërsi, sipas shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërsa, sa i përket kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në pikën 3, të nenit 2 të projektligjit, garantohet i njëjti përfitim që merr kryetari i Gjykatës Kushtetuese sa i takon shtesës për pozicion drejtues.

Në saje të të gjitha parashikimeve të sipërpërmendura, arrihet barazimi në status dhe pagë të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Funksioni	Paga e Presidentit 0.96*425000	Shtesa	Total	Vjetërsi 20*2	Shtesa 20%	Total Bruto
Gjyqtar i GJK-së	408 000	236 640	644 640		-	644 640
Gjyqtari i KPA-së	408 000	175 440	583440	61 200	-	644 640
Kryetar i GJK-së dhe KPA-së					128 928	773 568
Këshilltari i KPA-së	326 400					326 400

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe është hartuar në përputhje me Kushtetutën. Dispozitat e tij janë në harmoni me rendin kushtetues e legjislacionin vendas. Përmes këtij projektligji garantohet zbatimi i nenit 138 të Kushtetutës, pasi paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit nuk ulet, por pëson rritje, ndërsa përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk preken.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis të BE-së*, pasi përbën një nismë për të rregulluar në mënyrë më të përshtatshme disa aspekte të veprimtarisë së përditshme të Gjykatës Kushtetuese.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 3 nene:

Në nenin 1 të projektligjit parashikohen shtesat dhe ndryshimet në nenin 17 të ligjit në fuqi, si:

- Ndryshimi i pikës 1, si vijon:

“1. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.96 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit, në çdo rast, nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

- Shtimin e pikës 1/1 pas pikës 1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Përveç pagës mujore, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese përfiton një shtesë për shkak të natyrës së veçantë të punës, në masën 58% për qind të pagës.”.

- Ndryshimi i pikës 2, si më poshtë:

“2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, për pozicionin drejtues përfiton edhe 20 për qind shtesë page mbi pagën mujore të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe shtesës për shkak të natyrës së veçantë të punës.”.

Neni 2 përmban dispozitën transitorë.

Sipas pikës 1, paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese indeksohet për herë të parë nga Këshilli i Ministrave jo më herët se data 1.1.2026.

Ndërsa sipas pikës 2, parashikohen shtesat që përfiton gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Ndërsa në pikën 3 parashikohet shtesa për pozicion drejtues që përfiton Kryetari i KPA.

Ndërsa neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit, 15 ditë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Gjykata Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Efekti i pritshëm është 33 983 580 lekë, të detajuara në tabelën bashkëlidhur këtij relacioni.

KËSHILLI I MINISTRAVE